



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 112-10684

Dt: 26.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11.13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, e më qëllim të formimin e Komisionit për konstatimin e gjendjes së saktë të hapësirave publike të cila janë në shfrytëzim nga operatori “Scorpion”, me dt. 26.02.2016, e miraton këtë:

**V E N D I M**

1. Formohet Komisioni për konstatimin e gjendjes reale të hapësirave publike të cila janë në shfrytëzim nga operatori “Scorpion” me numër të kontratës 05/10/06 e dt. 15.02.2006 të cilit me dt. 01.03.2016 i skadon afati i urdhëresës për lirim të hapësirave, në këtë përbërje:

1. Drenusha Nixha, kryesuese e Komisionit
2. Riza Morina, anëtar
3. Merita Vula, anëtare
4. Ahmet Bajrami, anëtar
5. Agron Gojani, anëtar

2. Komisioni i cekur në piken e parë të këtij vendim ka për detyrë që të bënë konstatimin e gjendjes reale të hapësirave publike të cila janë në shfrytëzim nga operatori “Scorpion” me numër të kontratës 05/10/06 e dt. 15.02.2006 pasi të njëjti me dt. 01.03.2016 i skadon afati i urdhëresës për lirim të hapësirave dhe të harton një procesverbale lidhur me gjendjen reale të hapësirave të cilat i ka në shfrytëzim operatori “Scorpion”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi u dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorisë për Punë Inspektuese
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

